

HAPAT PËR REALIZIMIN E TË DREJTËS SË KOMPENSIMIT NË TË HOLLA PËR VIKTIMAT E VEPRAVE PENALE ME DHUNË NË MAQEDONINË E VERIUT



Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



BASHKIMI EVROPIAN

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës



**Hapat për realizimin e të
drejtës së kompensimit
në të holla për viktimat e
veprave penale me dhunë
në Maqedoninë e Veriut**

Tetor 2024

Kjo broshurë u prodhuan me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit(ve). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë), me përjashtim të riprodhimit për qëllime tregtare për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmentet nuk përdoren jashtë kontekstit, nuk jepen informacione të paplota dhe nuk e keqorientojnë lexuesin sa i përket natyrës, fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit. Teksti burimor duhet të njilhet gjithmonë si vijon "©Këshilli i Evropës, 2024". Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/përkthimin e të gjithë këtij dokumenti ose e pjesëve të caktuara të tij, duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Komunikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int).

Të gjitha korrespondencat e tjera në lidhje me këtë publikim duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Komunikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasbourg Cedex France), Tel. +33 (0)3 88 41 20 00; E-mail: Horizontal.Facility@coe.int @Këshilli i Evropës, Tetor 2024. Të gjitha të drejtat e rezervuara. I licencuar në Bashkimin Evropian sipas kushteve të miratuara.

Fotografi: Shutterstock

I. A kam të drejtë për kompensim në të holla?

Nëse jeni viktimë e një vepre penale me dhunë, ju keni të drejtë në kompensim në të holla për shkak të pasojave që keni pësuar si rezultat i veprës penale të kryer me dashje me përdorimin e forcës fizike ose veprimeve të tjera që kanë rezultuar në dëmtim të rëndë të shëndetit.

Ju jeni **viktimë e drejtpërdrejtë** nëse keni pësuar një dëmtim të rëndë të shëndetit fizik ose mendor si pasojë e drejtpërdrejtë e veprës penale të kryer.

Ju jeni gjithashtu **një viktimë e drejtpërdrejtë** nëse keni pësuar një dëmtim të rëndë të shëndetit fizik ose mendor si rezultat i:

- përpjekjes për të parandaluar kryerjen e një vepre penale të dhunshme,
- ofrimit të ndihmës për viktimën, dhe
- asistimit të policisë gjatë privimit nga liria të kryerësit të veprës penale të dhunshme.

Ju gjithashtu mund të jeni **viktimë indirekte** nëse jeni anëtar i familjes (bashkëshort apo partner jashtë martesor, fëmijë, prind) së viktimës së drejtpërdrejtë e cila ka vdekur për shkak të veprës penale lidhur me dhunën.

E drejta për kompensim në të holla si viktimë, ju takon pavarësisht nga statusi juaj, gjegjësisht pavarësisht nëse jeni shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, shtetas i huaj¹, në bazë të parimit të reciprocitetit ose të një marrëveshje ndërkombëtare, person pa shtetësi ose person i paevidentuar në librin amë të të lindurve, nëse në kohën e kryerjes së veprës penale qëndroni në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

¹ kompensim në të holla i paguhet viktimës që është shtetas i një shteti anëtar të Bashkimit Evropian dhe do të fillojë të zbatohet nga data e pranimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian.



Çfarë është vepër penale me dhunë?

Vepra penale me dhunë mund të jetë e lidhur me dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunën në familje, vepër penale me të cilën cenohet integriteti gjinor, vepër penale që lidhet me vendosjen e skllavërisë dhe transportin e personave në skllavëri, trafikimin e qenieve njerëzore dhe trafikimin e fëmijëve.

Vepër penale me dhunë mund të jetë gjithashtu edhe një vepër penale tjetër me anë të së cilës me një veprim, mjet ose pajisje përgjithësisht të rrezikshme, rrezikohet jeta ose pasuria e personit, që ka shkaktuar vdekjen ose lëndime të rënda trupore ose dëmtimin e rëndë të shëndetit fizik ose mendor të një ose më shumë personave.



Cilat kushte duhet t'i plotësoj që të mund të realizoj të drejtën për kompensim në të holla?

Parakusht për realizimin e të drejtës për kompensim në të holla është që, vepra penale të jetë e evidentuar ose e raportuar në stacionin policor ose në prokurorinë publike.

Me kërkesën tuaj ose me kërkesën e prindit/kujdestarit ose autorizuesit tuaj, policia ose prokuroria publike është e detyruara t'ju lëshojë njoftim të duhur, procesverbal se është pranuar kallëzim, shënim zyrtar ose vërtetim që vepra është raportuar ose regjistruar si vepër penale.

Ju keni të drejtë për kompensim në të holla pavarësisht nëse kryerësi i veprës penale është i njohur dhe pavarësisht nëse kundër kryerësit të veprës penale është nisur procedurë penale, madje edhe nëse ka pengesa faktike ose ligjore për zhvillimin e procedurës penale.

IV.

Cilat lloje të kompensimit në të holla mund t'i fitoj?

Ju keni të drejtë për kompensim në të holla, edhe atë për:

- shpenzimet për shërim dhe pajisje mjekësore (shuma maksimale deri në 2,000 euro në kundërvlerë të denarit),
- të ardhurat e humbura (shuma maksimale deri në 2,000 euro në kundërvlerë të denarit),
- shpenzimet e varrimit (vetëm nëse nuk i keni arkëtuar të njëjtat në një bazë tjetër),
- mirëmbajtje e humbur (shuma maksimale prej 4,500 euro në kundërvlerë të denarit), dhe
- ndihmë solidariteti për pasojat e pësuar nga vepra penale (shuma maksimale deri në 500 euro në kundërvlerë të denarit).

Shuma e kompensimit në të holla që mund të fitoni në të gjitha llojet, nuk mund të tejkalojë shumën totale prej 5,000 euro në kundërvlerë të denarit.

V.

Cila është procedura e realizimit të së drejtës për kompensim në të holla?

Procedura fillon duke parashtruar kërkesë me shkrim pranë Komisionit për kompensim në të holla (në tekstin e mëtutjeshëm: Komisioni) i cili vendos mbi kërkesën.

Ekzemplari – Formulari i Kërkesës për realizimin e kompensimit në të holla të viktimave nga vepra penale me dhunë mund të shkarkohet dhe të printohet nga ueb faja e Komisionit. Kërkesa mund të dorëzohet drejtpërdrejt nëpërmjet arkivit të Ministrisë së Drejtësisë ose të dërgohet me postë ose në formë elektronike.

Kontakt: Ministria e Drejtësisë, rr. “Dimitrie Çupovski” nr. 9, 1000 Shkup
Faaja e internetit: www.komisijazanadomestoknazrtvi.mk
Adresa elektronike: contact@komisijazanadomestoknazrtvi.mk
Telefon +389 23116 493 lok.119

Për viktimat fëmijë/persona me aftësi veprimi të kufizuar ose të hequr

Nëse viktimat janë fëmijë ose nuk ka aftësi veprimi, kërkesa do t'i paraqitet Komisionit nga prindi, kujdestari ose nga autorizuesi.

Prindi ose kujdestari për ndihmë dhe informacione mund t'u drejtohet shoqatave të qytetarëve, të regjistruara për dhënie e ndihmës juridike falas ose në njësitë rajonale të Ministrisë së Drejtësisë.

Çfarë duhet të përmbajë kërkesa për kompensim në të holla?

Më së miri është që kërkesa të parashtrohet në një **formular** të cilin mund ta gjeni në këtë material informativ ose ta merrni nga zyrat e shoqatave të qytetarëve të regjistruara për dhënie e ndihmës juridike falas ose në njësitë rajonale të Ministrisë së Drejtësisë.

Kërkesën mund ta dorëzoni në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik ose në gjuhë tjetër zyrtare të cilën e flasin të paktën 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj ose në gjuhën që e kuptoni.

Nëse përdorni një kërkesë tuaj, kini kujdes në elementet e domosdoshme më poshtë, të cilat duhet t'i përmbajë kërkesa:

- të dhënat personale të parashtruesit të kërkesës, gjegjësisht të viktimës, nëse nuk është i njëjti person me parashtruesin e kërkesës,
- përshkrimi i veprës penale (data, vendi dhe mënyra e kryerjes),
- datën kur është regjistruar ose raportuar kryerja e veprës penale në polici ose prokurori publike,
- përshkrimi i pasojave nga vepra penale,
- pretendimet nëse viktimë është në dijeni se kundër kryerësit të veprës penale po zhvillohen procedurë penale, para cilit organ kompetent, si dhe numri nën të cilin po udhëhiqet lënda,
- deklaratë për realizimin e kompensimit të njohur me ligj të realizuar sipas bazave të tjera juridike, dhe
- llojin e kompensimit që e kërkon viktimë.

Me kërkesën për fillimin e procedurës për realizimin e kompensimit, dorëzohen shkresa fotokopje dhe bëhet këqyrje në dokumentet origjinale ose dokumentet e verifikuar të më poshtme:

- dokument për identifikim personal,
- prova e shtetësisë, vendbanimit ose vendqëndrimit, me përjashtim të viktimës pa shtetësi ose viktimës që është person i paevidentuar në librin amë të të lindurve,
- dokument përkatës nga policia ose prokuroria publike se vepra penale është regjistruar ose raportuar,
- prova (dokumentacion mjekësor) nga i cili rezulton se viktimë ka pësuar lëndime të rënda trupore, dëmtime të rënda të shëndetit mendor ose fizik,
- certifikatë nga libri amë i të vdekurve, nëse vdekja e viktimës ka ndodhur si pasojë e veprës penale,
- prova për paaftësinë për të punuar në përputhje me rregulloret për sigurim pensional dhe invalidor,
- prova se viktimë indirekte i ka paguar shpenzimet e varrimit,
- deklaratë e nënshkruar me dorën e vet për mos realizimin e kompensimit të njohur me këtë ligj të realizuar mbi baza të tjera ligjore,
- të dhënat për llogarinë e tij personale të transaksionit, dhe
- dokumente të tjera të cilat i posedon viktimë, e me të cilat dëshmohet përmbushja e kushteve për realizimin e kompensimit.

Çfarë shpenzimesh kam në këtë procedurë?

Në këtë procedurë nuk paguhen taksat administrative.

Për shtetasit e huaj/persona pa shtetësi

Keni të drejtë për përkthyes gjatë gjithë procedurës, ndërsa shpenzimet mbulohen nga shteti.

Ndaj dokumenteve që do të dorëzoni në gjuhë të huaj, është e nevojshme të bashkëngjitni përkthim të verifikuar në gjuhën maqedonase. Shpenzimet e përkthimit mbulohen nga shteti. Të njëjtat duhet të ceken në kërkesën tuaj që t'ju kompensohen nga Komisioni.

Çfarë duhet pasur kujdes gjatë procedurës?

Komisioni, pas pranimit të kërkesës suaj me dokumentet e nevojshme, do t'ju lëshojë *vërtetim për pranim* të kërkesës, ku është cekur personi për kontakt që është kompetent për procedim dhe afati deri kur do të merret vendimi, nëse është e mundur.

Nëse, gjatë zhvillimit të procedurës për relaizimin e të drejtës së kompensimit në të holla, realizoni një të drejtë sipas një ligji tjetër, ju duhet të njoftoni Komisionin në afat prej shtatë ditëve nga realizimi i së drejtës, e gjithashtu duhet të dorëzoni dëshmi për të drejtën dhe kompensimin e realizuar.

Gjatë procedurës, me përjashtim, Komisioni mund t'ju thërrasë që të jepni deklaratë për të cilën përpilon procesverbal ose shënim zyrtar. Kërkoni kopje të asaj që keni deklaruar dhe që e keni nënshkruar.

Nëse kërkesa e parashtruar nuk është e plotë, Komisioni do t'ju thërrasë në afat prej 30 ditëve nga data e pranimit të njoftimit, që ta korrigjoni ose plotësoni kërkesën me provat, të cilat janë të nevojshme për të marrë vendim.

Gjatë gjithë procedurës, Komisioni është i vëmendshëm ndaj të dhënave tuaja personale që i keni dhënë dhe obligohet të sigurojë fshehtësinë dhe mbrojtjen e tyre nga keqpërdorimi.

Cili është afati i fundit për të parashtruar kërkesën?

Kërkesa parashtrohet më së voni në afat prej *tre vite* nga dita kur është kryer vepra penale të cilën e shkruani në kërkesën për kompensim.

Nëse për arsye shëndetësore nuk jeni në gjendje të parashtroni kërkesën brenda tre vjetësh nga dita në të cilën është kryer vepra penale, që ceket në kërkesën për kompensim, kërkesa duhet të parashtrohet në afat prej gjashtë muajve, nga dita në të cilën arsyet për të cilat nuk keni qenë në gjendje të parashtroni kërkesën kanë pushuar së ekzistuari, e më së voni në afat prej *pesë viteve* nga dita e kryerjes së veprës penale.

Për viktimat fëmijë/personat me aftësi veprimi të kufizuar ose të hequr

Nëse viktima është një fëmijë ose një person me aftësi veprimi të kufizuar ose të hequr, ndërsa prindi ose kujdestari nuk ka paraqitur një kërkesë për kompensim brenda tre viteve nga dita kur është kryer vepra penale që është cekur në kërkesën për kompensim, afati prej tre vitesh fillon të rrjedh nga dita kur personi mbush 18 vjet ose nga dita kur viktima arrin moshën madhore është raportuar kryerja e veprës penale ose nga dita kur personit i rikthehet aftësia e veprimit.

VI.

Çfarë vendimi mund të sillet për kërkesën time për kompensim në të holla?

Me kërkesën tuaj, lidhur me të drejtën dhe shumën e kompensimit në të holla vendos Komisioni për kompensim në të holla për viktimat e veprës penale me dhunë.

Komisioni vepron dhe vendos me një kuorum prej tre anëtarësh, ndërsa vendimet merren me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

Cili është afati që do të marr përgjigje për kërkesën për kompensim në të holla?

Për të drejtën e kompensimit në të holla, për llojin dhe lartësinë e kompensimit vendos Komisioni me aktvendim, më së voni në afat prej 60 ditë nga dita e pranimit të kërkesës së plotë për kompensim.

Përfundim

Nëse baza për realizimin e kompensimit dhe lartësia e kompensimit nuk mund të përcaktohen pa fakte dhe rrethana, të cilat do të përcaktohen në procedurë të përfunduar të plotfuqishme penale, vendimi merret më së voni në afat prej tre muajve nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit në procedurën penal.

Llojet e vendimeve:

- aktvendim me të cilin hidhet poshtë kërkesa si e dorëzuar jo në kohë, e pa lejuar ose e dorëzuar nga një person i paautorizuar,
- aktvendim me të cilin hidhet poshtë kërkesa si e parregullt ose jo e plotë, nëse kërkuesit të kërkesës i kërkohet ta korrigjojë ose ta plotësojë atë, e këtë ai nuk e ka bërë në afatin e përcaktuar,
- aktvendim me të cilin vleftësohet kërkesa tërësisht ose pjesërisht për kompensim dhe përcakton llojin dhe lartësinë e kompensimit në të holla,
- aktvendim me të cilin e refuzon kërkesën si të pabazë.

Aktivendimi për të drejtën e kompensimit në të holla ju dorëzohet me shkrim në adresën që keni dhënë në kërkesë, pa vonesë.

Për viktimat fëmijë/personat me aftësi veprimi të kufizuar ose të hequr

Aktivendimi për të drejtën e kompensimit në të holla dorëzohet me shkrim në adresën që kujdestari ose prindi e ka dhënë në kërkesë, pa vonesë.

Nëse në ndërkohë e keni ndryshuar adresën, menjëherë pas ndryshimit, patjetër duhet ta njoftoni Komisionin për adresën tuaj të re.

Kërkesa do të refuzohet kur me kompensimin nga kryerësi i veprës penale, plotësisht është kompensuar dëmi.

VII.

Pagesa e kërkesës në të holla

Në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktivendimit me të cilin është miratuar pagesa e kompensimit, Komisioni kryen pagesën e cila duhet të bëhet ekskluzivisht në llogarinë tuaj të transaksionit të cilën ia dorëzoni Komisionit.

Për viktimat fëmijë/personat me aftësi veprimi të kufizuar ose të hequr

Komisioni kryen pagesën në llogarinë e transaksionit të prindit ose kujdestarit të viktimës.

Nëse komisioni ju paguan kompensim në të holla, kurse Ju keni realizuar kompensim të plotë ose të pjesshëm nga kryerësi i veprës penale, shteti ka të drejtë t'ju kërkojë ta ktheni shumën të cilën jua ka paguar.

VIII. Mbrojtje gjyqësore

Kundër aktvendimit të Komisionit keni të drejtë në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit të dorëzoni padi për iniciimin e kontestit administrativ në Gjykatën Administrative.

Padia mund të dorëzohet drejtpërdrejt në gjykatë në formë të shkruar, me postë në adresë ose nëpërmjet mjeteve elektronike.

Nëse e keni dorëzuar padinë drejtpërdrejt në gjykatë, personi që e ka pranuar padinë obligohet t'ju lëshojë vërtetim për pranim me numër të regjistruar të padisë.

Nëse padinë e keni dërguar me postë si dërgesë e rekomanduar, data e dorëzimit në postë konsiderohet data kur padia është dorëzuar në gjykatë. Ruajeni fletën si provë se keni dorëzuar padinë tuaj në gjykatë. Pastaj drejtojuni gjykatës për të marrë një numër nën të cilin udhëhiqet lënda juaj.

Nëse keni dorëzuar padi nëpërmjet mjeteve elektronike, ajo do të konsiderohet të jetë dorëzuar në kohën kur do të vihet re në serverin për mesazhe dalëse elektronike. Një padi e tillë do të vërtetohet përmes mjeteve elektronike me nënshkrim elektronik nga gjykata, pa asnjë vonesë.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës Administrative, mund të parashtroni ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit.

Ankesa dorëzohet në Gjykatën Administrative, ndërsa lidhur me ankesën vendos Gjykata e Lartë Administrative.

Kontakt: Gjykata Administrative, rr. "Dame Gruev", nr. 6, 1000 Shkup
Tel. 02 3203-200 ose 02 3203-231

Padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit të Komisionit.

IX.

Shpenzimet e procedurës

Në procedurën e realizimit të kompensimit në të holla, nuk paguhen taksa administrative.

Nëse nuk jeni shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjatë gjithë procedurës keni të drejtë për përkthyes në shpenzim të Komisionit.

X.

Ndihmë juridike falas

Gjatë procedurës për ushtrimin e të drejtës për kompensim në të holla, keni të drejtë për ndihmë juridike falas.

Për të fituar ndihmë juridike primare gjatë plotësimit të kërkesës, duhet t'i drejtoheni personit të autorizuar zyrtar në njësitë rajonale të Ministrisë së Drejtësisë sipas vendbanimit/vendqëndrimit tuaj, shoqatës së autorizuar² ose klinikës juridike (në kuadër të fakulteve juridike).

Ju gjithashtu mund të kërkonti *ndihmë juridike* sekondare që përfshin përfaqësimin falas nga një avokat në të gjithë procedurën. E njëjta duhet të miratohet paraprakisht me Vërtetim të lëshuar nga njësia rajonale e Ministrisë së Drejtësisë ose me Aktvendim të Ministrisë së Drejtësisë.

Personi i autorizuar zyrtar nga njësitë rajonale të Ministrisë së Drejtësisë sipas vendbanimit/vendqëndrimit tuaj, shoqatës së autorizuar ose klinikës juridike (në kuadër të fakulteteve juridike) mund t'ju ndihmojë në procedurën e marrjes së ndihmës juridike sekondare.

Kontakte më të rëndësishme:

Ministria e Drejtësisë, rr. "Dimitrie Çupovski" 9, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Adresa elektronike cabinet@justice.gov.mk

Kontakt tel. +389 (0)2 3116 - 493,

+389 (0)2 3116 - 648

Komisioni për kompensim në të holla.

Faqja e internetit: www.komisijazanadomestoknazrtvi.mk

Adresa elektronike: contact@komisijazanadomestoknazrtvi.mk

Tel. +389 23116 493 лок.119

Personi i kontaktit: Andrijana Gjorgjevska, Udhëheqëse e Njesisë për falje dhe kompensim të dëmit,

Kontakt tel: +389 23116 493 лок.119,

cel: +389 (0)70 314 453,

Adresa elektronike: agjorgjevska@justice.gov.mk

² <https://www.pravda.gov.mk/bpp>

Njësitë Rajonale të Ministrisë së Drejtësisë

Njësitë dhe zyrat rajonale të Ministrisë së Drejtësisë		ADRESA	Telefoni	e-mail:
1	NR Radovish dhe Berovë	rr. "Dimitar Vlahov" nr. 10, 2330, Berovë	075 388-783	jjukadupkarska@mjustice.gov.mk
	Zyra – Berovë	bul. "Aleksandri i Maqedonisë" pn, 2420, Radovish	075 388 - 771	dsvirikova@mjustice.gov.mk
2	NR Manastir	Bul. "1 Maji" pn. 7000 Manastir	075 388- 761	mruteska@mjustice.gov.mk
	NR Novaci	Komuna e Novacit	075-388-719	
	NR Mogilla	Komuna e Mogillës	075-388-739	
3	NR Vallandovë	rr. "4 Korriku" nr.1, 1460, Vallandovë	075-388-752	fkaburova@mjustice.gov.mk
	NR Viniçë dhe Koçan			
4	Zyra – Viniçë	rr. "Guri i Bardhë" nr. 13, 2310, Viniçë	075 388-695	gdimitrov@mjustice.gov.mk
	Zyra – Koçan	rr. "Rade Kratovçe" nr.1, 2300, Koçan	075-388-769	mmancova@mjustice.gov.mk
	NR Gjevçjeli	rr. "Marshall Tito" nr.170, 1480 Gjevçjeli		ssuteva@mjustice.gov.mk
		rr. "Marshall Tito" nr.170, 1480 Gjevçjeli	075-388-659	mitepeev@mjustice.gov.mk
6	NR Gostivar dhe Dibër			
	Zyra – Gostivar	rr. "Vëllezërit Ginoski" pn, 1230, Gostivar	075 388-764	
	Zyra – Dibër	rr. "8 Shtatori" pn, 1250, Dibër	075 388-786	toninkoleci@mjustice.gov.mk
7	NR Dellçevë	rr. "Metodi Mitevski Brico", nr. 40, 2320, Dellçevë	075 388-754	gstoimenovski@mjustice.gov.mk
	NR Prilep, Demir Hisar dhe Krushevë			
8	Zyra – Prilep	rr. "Pitu Guli" nr. 2, 7500, Prilep	075 388-753	arminaferrat@mjustice.gov.mk
	Zyra - Demir Hisar	rr. "Bitollska" pn, 7240, Demir Hisar	075 388-756	amitrajcevska@mjustice.gov.mk
	Zyra – Krushevë	rr. "Nikolla Gjurmë" pn, 7520, Krushevë		
9	NR Negotinë dhe Kavadar			
	Zyra – Negotinë	rr. "Aco Haxhi Ilov" nr. 2, 1440, Negotinë	075 388-718	jkamceva@mjustice.gov.mk
	Zyra – Kavadar	Sheshi "Marshall Tito" pn, 1430, Kavadar	075 388-696	cbastovanova@mjustice.gov.mk
10	NR Kërçovë	rr. "Boris Kidriç" nr. 1, 6250, Kërçovë	075 388-767	nuriselmani@mjustice.gov.mk

11	NR Kriva Pallanë dhe Probishtip				
	Zyra - Kriva Pallanë	rr. "Shën Joakim Osogovski" nr. 17, 1330, Kriva Pal.	075 388-749	sileska@mjustice.gov.mk	
12	NR Kumanovë dhe Kratovë				
	Zyra - Kumanovë	rr. "11-të Tetori" pn, Kumanovë	075 388-671	fstevanovic@mjustice.gov.mk	
13	NR Makedonski Brod				
	Zyra - Kratovë	rr. "Sheshi Sh. Gjorgji Kratovski" pn	075 388-763	vericazdravkovska@mjustice.gov.mk	
14	NR OHër				
	Zyra - Kratovë	rr. "7-të Shtatori" nr. 4, Makedonski Brod	075 388-785	ivicadimoski@mjustice.gov.mk	
15	NR Resnjë				
	Zyra - Kratovë	rr. "Dimitar Vllahov" nr. 57, 6000, Ohër	075-388-751	tkoceski@mjustice.gov.mk	
16	NR Sveti Nikollë dhe Veles				
	Zyra - Sveti Nikollë	Sheshi "Car Samuil" pn, 6310, Resnjë	075 388-685	dbarandovska@mjustice.gov.mk	
17	NR Strugë				
	Zyra - Veles	Sheshi "Ilinden" nr. 12, 2220, Sveti Nikollë	075 388-782	gmlahov@mjustice.gov.mk	
18	NR Strumicë				
	Zyra - Veles	rr. "Panko Brashnar" pn, Veles	075-388-765	nkalauzarova@mjustice.gov.mk	
19	NR Tetovë				
	Zyra - Veles	rr. "Brigadat Proleteriane" pn, 6330 Strugë	075 388-748, 075 388-673	sevimasalievka@mjustice.gov.mk	
20	NR Shkup, Karposh, Qendër, Çair, Gazi Babë dhe Kisella Vodë				
	Zyra - Karposh	rr. "Sando Masev" nr. 1, 2400, Strumicë	075-388-784	mklesova@mjustice.gov.mk	
21	NR Shtip				
	Zyra - Qendër	rr. "Dervish Cara" nr. 68, 1200, Tetovë	075-388-738	ezejneli@mjustice.gov.mk	
22	NR Tetovë				
	Zyra - Qendër	rr. "Dervish Cara" nr. 68, 1200, Tetovë	075-388-690	fselami@mjustice.gov.mk	
23	NR Tearcë				
	Zyra - Qendër	Komuna e Tearcës	075-388-649		
24	NR Bogovinë				
	Zyra - Qendër	Komuna e Bogovinës	075-388-692		
25	NR Shtip				
	Zyra - Qendër	rr. "Vasil Gllavinov" nr. 4, 2000, Shtip	075 388-739	marikadeleva@mjustice.gov.mk	
26	NR Shkup, Karposh, Qendër, Çair, Gazi Babë dhe Kisella Vodë				
	Zyra - Karposh	rr. "Boris Trajkovski" pn. Komuna Kisella Vodë, baraka 9 dhoma 16	075 388-747	vvasileska@mjustice.gov.mk	
27	NR Shtip				
	Zyra - Qendër	/	/		
28	NR Shtip				
	Zyra - Çair	rr. "Orce Nikollov" nr.138	075 388-674	silvijamedziti@mjustice.gov.mk	
29	NR Shtip				
	Zyra - Gazi Babë	rr. "Bul. Aleksandri i Maqedonisë" pn. 1000, Shkup	075-388-779	remzibeqiri@mjustice.gov.mk	
30	NR Kisella Vodë				
	Zyra - Kisella Vodë	rr. "Boris Trajkovski" pn. Komuna Kisella Vodë, baraka 9 dhoma 16	075-388-774	zstankovic@mjustice.gov.mk	
31	NR Shuto Orizare				
	Zyra - Shuto Orizare	rr. "Haxhi Jovan Shishko" nr. 36	075-388-762		

Ky produkt u prodhuan me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit(ve). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.coe.int

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke e ruajtur kulturën diversitetit, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar t'i ndajë arritet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të tij.

www.europa.eu

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës

